



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA PUKË**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**DEKLARATË PUBLIKE**

Nga: **Kryetari i Këshillit Bashkiak Pukë Gjon Gjoka**

Për: **Qytetarët e Bashkisë Pukë**

Çështja: **Angazhimi për përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies publike**

Të nderuar qytetarë të Pukës

Në emër të Këshillit Bashkiak, dëshiroj të ndaj me ju hapat konkretë që po ndërmarrim për të rritur transparencën dhe pjesëmarrjen tuaj në vendimmarrjen vendore. Bazuar në raportin tonë të fundit të veprimtarisë për vitin 2024, kemi identifikuar arritjet tona, por edhe fushat ku duhet të përmirësohemi urgjentisht.

Transparenca nuk është thjesht një detyrim ligjor, por shtylla e besimit ndërmjet nesh. Prandaj, bazuar në analizën e punës sonë, ne angazhohemi publikisht për masat e mëposhtme:

- Përmirësimi i cilësisë së transmetimeve live: Kemi dëgjuar shqetësimet tuaja lidhur me cilësinë e zërit gjatë transmetimit të mbledhjeve në Facebook. Do të investojmë menjëherë nga buxheti i ri për të garantuar audio dhe video të pastër. Çdo qytetar ka të drejtë të dëgjojë qartë se si diskutohen problemet e tij.
- Shtimi i komunikimit me qytetarët: Gjatë vitit të kaluar kemi regjistruar shume pak kërkesa dhe shumë pak ankesa. Kjo tregon se duhet të dalim më pranë jush. Do të intensifikojmë takimet dhe fushatat e informimit për t'ju ftuar të adresoni çdo shqetësim pranë Këshillit.
- Rritja e pjesëmarrjes së grave në dëgjesa publike: Në seancat tona të konsultimeve morën pjesë 129 qytetarë, por nga këta vetëm 17 ishin gra. Ky raport duhet të ndryshojë. Do të krijojmë mekanizma lehtësues dhe thirrje të dedikuara për të siguruar që zëri i grave dhe vajzave të Pukës të dëgjohet plotësisht.
- Transparenca e plotë e buxhetit dhe vendimeve: Regjistri online i transparencës dhe ai i kërkesë-ankesave do të përditësohen në kohë reale. Buxheti i ri prej 14,167,580 Lekë do të jetë i detajuar dhe i aksesueshëm për çdo kontroll qytetar.
- Ndjekja e rekomandimeve tuaja: Nga 48 rekomandimet e dhëna prej jush për infrastrukturën, ndriçimin dhe shërbimet, pjesa dërmuese u mor parasysh. Ne do të monitorojmë hap pas hapi administratën e Bashkisë për zbatimin e tyre.

Këshilli Bashkiak Pukë ju përket juve. Ju ftoj që të bëheni pjesë aktive e mbledhjeve tona online, të merrni pjesë në dëgjesat publike dhe të kërkonit llogari për çdo vendim.

Ju faleminderit për bashkëpunimin dhe besimin tuaj!